




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr.8, datë 23.02.2023

PËR



**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK
SHOQËRISË “AUTOVISION AL” SH.P.K**


Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik shoqërisë “Autovision Al” me adresë Rruga “Dervish Hatixhe” Kompleksi Moxart hyrja 1 Tiranë Qarku Tiranë sipas Miratimit Paraparak me Nr. 14124/2, datë 18.12.2018 “Për vazhdim procedure për ndërtimin e burimit të ri gjenerues të energjisë, hidrocentraleve “Zgallo 1 & Zgallo 2”, në rrjedhën e sipërme të lumit Shkumbin, në degët anësore të tij përkatësisht në përroin e Gurit dhe degëve të tij dhe përroin e Zgallos, Bashkia Pogradec, Qarku Korçë”, si dhe shtyrjes së afatit të Miratimit Paraparak për HEC “Zgallo 1” dhe “Zgallo 2” me nr.8971/1 prot., datë 13.12.2022 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për shoqërinë “Autovision Al” sh.p.k.
2. Treguesit paraparak janë si më poshtë:
HEC Zgallo 1

Vendndodhja e veprës së marrjes 1

- X= 538938; Y=4523415; Z= 1700 m.m.n.d. (KRGJSH)

- 
- Prurja llogaritëse: 0.2 m³/s
 - Prurja mesatare vjetore: 0.12 m³/s
 - Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.048 m³/s
 - Prurja ekologjike: 0.01211 m³/s

Vendndodhja e veprës së marrjes 2

- X= 538421; Y= 4524155; Z= 1700 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 0.12 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.06 m³/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.024 m³/s
- Prurja ekologjike: 0.00605 m³/s

Vendndodhja e veprës së marrjes 3

- X= 537746; Y= 4524159; Z= 1700 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 0.05 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.03 m³/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.012 m³/s
- Prurja ekologjike: 0.00303 m³/s

Vendndodhja e veprës së marrjes 4

- X= 537589; Y= 4524331; Z= 1700 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 0.04 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.012 m³/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.005 m³/s
- Prurja ekologjike: 0.00121 m³/s

Vendndodhja e godinës së Centralit

- X= 538736; Y= 4525899; Z= 1450 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: 0.41 m³/s
- Prodhimi vjetor i parashikuar: 2.892.334 kwh/vit
- Fuqia e instaluar: 827 kwh
- Vlera totale e investimit: 143,268,414 lekë me TVSH.

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH), ku kanali i largimit të godinës së HEC-it ZGALLO 1,

- X= 538758; Y= 4525895; Z= 1448 m.m.n.d. (KRGJSH)

HEC Zgallo 2

Vendndodhja e veprës së marrjes 1

- X= 538204; Y= 4527746; Z= 1170 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 0.22 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.12 m³/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.09 m³/s
- Prurja ekologjike: 0.0134 m³/s



Vendndodhja e godinës së Centralit

- X= 539864; Y= 4528845; Z=794 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: 0.2 m³/s
- Prodhimi vjetor i parashikuar: 2.085.986 kwh/vit
- Fuqia e instaluar: 677 kwh
- Vlera totale e investimit: 99,440,130 lekë me TVSH

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH), ku kanali i largimit të godinës së HEC-it ZGALLO 2,

- X= 539917; Y= 4528864; Z= 790 m.m.n.d. (KRGJSH)

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SHKUMBIN

MAJLINDA PERRIU

